**OBLIGIMET E KOMUNAVE NGA AGJENDA EVROPIANE**

**PLANI GJITHPËRFSHIRËSE I KOMUNAVE JANAR-QERSHOR 2024**

| | |
|---|---|
| Data e dorëzimit të raportit: | 28.06.2024 |
| Emri i komunës | Komuna e Rahovecit |
| Emri i Kryetarit të Komunës | z. Smajl Latifi |
| Emri i Zyrtarit Komunal për Integrime Evropiane : | Gërmia Shala |
| Detajet kontaktuese: | 044/778-652 |

- BLLOKU I: KRITERET POLITIKE

| 1. ADMINISTRATA PUBLIKE | | | | Neni 120 i MSA-së: Administrata publike |
|---|---|---|---|---|
| 1.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal, përfshirë komunat e sapo formuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal | Të gjitha Drejtoritë/ Njësitë/ burimet njerëzore | 1. A është hartuar programi i trajnimeve për vitin 2024 në komunën tuaj? *Nëse po, ju lutemi të ofroni një dokument të tillë.* | 1. Po, është hartuar përmes sistemit HRMIC.<br>I cili program është i bashkuar me planin e punës se zyres së personelit. | |
| 1.2.Të ngritet transparenca e punës dhe vendimmarrjes të nivelit lokal | Zyra e Kryetarit /Zyra e informimit | 1. A ka hartuar komuna juaj Startegjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, nëse po ju lutem të bashkangjiteni strategjinë e miratuar?<br><br>2. A ka komuna juaj Planin vjetor të komunikimit, nësë po ju lutem të bashkangjitni Planin ?<br><br>3. A është duke u zbatuar Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të hapur në Komuna.<br><br>4. A është caktuar zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik në komunën tuaj? Ju lutem bashkangjitni vendimin.<br><br>5. Lidhur me rezultatet e procesit të konsultimit publik, a publikon komuna juaj raportin me të gjitha | 1. Komuna e Rahovecit e ka të hartuar Strategjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun me Nr.Prot. 01/291/22 më datë 30.3.2022.<br><br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/06/Strategjija-Komunale-per-Informim-dhe-Komunikim-2022-2025.pdf<br><br>2. Po ka plan, dhe është i publikuar në këtë vegëz:.<br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/12/Plani-i-Punes-per-vitin-2024-i-Zyres-per-Informim.pdf<br><br>3. Po këtë vit kemi filluar me zbatimin e Udhëzimit të ri, në rubrikat konsultime dhe dëgjime mund t'i shihni njoftimet me takime pblike bazuar mbi këtë udhëzim:<br><br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=317<br><br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=32047<br><br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=32041<br><br>4. Po vazhdon të mbetet e njëjta.<br><br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/06/NRP-02-687-2021-Vendim-per-caktimin-e-zyrtarit-pergjegjes-per-koordinimin-e-konsultimeve-degjimeve-dhe-takimeve-publike-ne-komunen-e-Rahovecit-znj.- | REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO<br>KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC<br>KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET<br>Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)<br>Nr./Br./No 4374 Nr. i faq/Br.str/No.pg 141<br>Data/Datum/Date 28 / 6 / 24<br>RAHOVEC / ORAHOVAC |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe a ofron sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara. (ju lutem e bashkangjitni linkun e publikimit të raporteve)? | Blerta-Gashi.pdf<br>5. Po vazhdimisht publikojmë raportet nga konsultimet publike:<br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/?cat=31507 | |
| 1.3.Të vazhdohet procesi i decentralizimit për komunat: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvecan, Leposaviq | **Drejtoria e Administratës** | 1. A janë emëruar Drejtorët e Drejtorive në komunën tuaj ?<br>2. Sa është numri i Drejtorive në komunën tuaj ?<br>3. A është themeluar Qendra për shërbim të qytetarëve?<br>4. A është duke funksionuar sistemi i intranetit në kuadër të shërbimeve administrative që ofron komuna juaj ?<br>5. A është arritë të bëhet migrimi i të dhënave nga uebfaqja e vjetër në atë të re? | 1. Komuna e Rahovecit ka emëruar Drejtorët në të gjitha Drejtoritë.<br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/drejtorite/<br>2. Komuna e Rahovecit gjithsej ka 12 Drejtori, me përbërje gjinore 3 gra dhe 9 burra.<br>3. Qendra për shërbim të qytetarëve është formuar në Komunen e Rahovecit dhe përbëhet nga 4 punonjës.<br>4. Sistemi i Intranetit është duke funksionuar mirë, të gjitha lëndët miratohen në afatet kohore të caktuara.<br>5. MAPL- si titullar i ëeb-faqeve të Komunave, në bashkëpunim me Kompaninë kontraktuese kanë provuar migrimin nga ëeb-faqja e vjeter ta bartin në ëeb-faqen e re dhe pjesërisht kanë pasur sukses. | |
| 3.SHOQËRIA CIVILE | | | | |
| 3.1.Të rritet bashkëpunimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si dhe të sigurohet financim publik për shoqërinë civile | **Drejtoria për Financa dhe Buxhet** | 1. Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konfrom Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve?<br>2. Sa është numri i OSHC-ve të përkrahura financiarisht nga komuna juaj ?<br>3. A ka përkrahur komuna juaj, projekte të OJQ-ve për përkrahjen e komuniteteve.<br>4. Nëse po, specifikoni numrin e projekteve të përkrahura dhe ju lutem ofroni shumën totale të këtyre projekteve? | 1. Për vitin 2024 janë planifikuar 250,000.00 euro.<br>2. Numri i OJQ-ve të përkrahura në periudhen janar-maj 2024 është 29.<br>3. Komuna e Rahovecit, respektivisht Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, ka përkrahur një projekt për organizatën joqeveritare SHL KOSOVA, për përkrahjen e komuniteteve në fushën e arsimit.<br>4. Në bashkëfinancim me UNMIK dhe me organizatën "Advancing Together," shuma totale e financuar për këtë projekt për Qendrën e Arsimit me Bazë në Komunitete - në Shkollën "Gezim Hamza Piktori "kap koston prej 10,000 eurosh. Ky është një projekt njëvjeçar, i cili implementohet nga OJQ-SHL Kosova nga Rahoveci. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | 5.A është bërë publikimi i thirrjeve dhe përfituesve në web faqet zyrtare të Komunës, nëse po bashkangjit linkun. | 5. Po është bërë publike. | |
| **4.LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT** | | | | **Neni 92: Lufta kundër terrorizmit - MSA** |
| 4.1.Të përforcohen strukturat e Kosovës në parandalimin dhe eliminimin e akteve terroriste dhe financimit të tyre | **Drejtoria a Arsimit/Zyra e Kryetarit** | 1. A keni organizuar ndonjë trajnim ose fushatë vetëdijësuese për parandalimin e të rinjëve që janë në rrezik për ekstremizëm dhe se si të veprojnë në raste të tilla ?<br><br>2. Cilat janë veprimet/aktivitetet që ka ndërmarrë komuna e juaj për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpiej në ekstremizëm të dhunshëm ?<br><br>3. A ka pasur ndonjë rast të raportuar në KKSB për aktivitetet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin? | 1. Komuna jonë, përkatësisht Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Stacionin Policor në Rahovec dhe Njësinë e Policisë së Komunitetit, gjatë kësaj periudhe kanë mbajtur ligjërata vetëdijësuese me nxënësit e shkollave të komunës sonë. Në këto aktivitete vetëdijësuese kanë marrë pjesë edhe psikologët e angazhuar nga DKA dhe përveç tjerash janë trajtuar edhe temat e radikalizmit të dhunshëm dhe ekstremizmit.<br><br>2. Përmes ligjëratave vetëdijësuese me të rinjtë është bërë e mundur që në komunën tonë të mos kemi raste të paraqitjes së radikalizmit, që mund të shpiej në ekstremizëm.<br><br>3. Jo, në KKSB nuk kemi pasur asnjë rast të tilllë të raportuar. | |
| 4.2.Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit si dhe të ashpërsohen sanksionet lidhur me mos deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit , si dhe për zbatimin e politikave të tjera kundër korrupsionit | **Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës** | 1. Sa është numri i rasteve të paraqitura të konflikteve të interesit nga zyrtarët komunal?<br><br>2. Sa është numri i anëtarëve të kuvendit që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të komunës? | 1 .Nuk kemi rast të paraqitur nga anëtarët e kuvendit rreth konfliktit të interesit.<br><br>2. Nuk ka pasur konflikt të interesit, në momentin që ka ne kërkojmë që të paraqiten dhe në momentin e votimit lirojnë sallën. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| 4.3.Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsion; | Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës | 1. A ka hartuar komuna juaj Planin Lokal për Integritet, konform Ligjit Nr. 08/L-017 për agjencin për parandalimin e korrupsionit nëse po ju lutem të bashkangjiteni planin e miratuar?<br><br>2. A ka komuna juaj koordinator që monitoron dhe raporton lidhur me planin për integritet, nëse po ju lutem të bashkangjitni vendimin. | 1. Po është hartuar Plani Komunal për Integritet.<br>Vegza:<br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/01/Plani-Komunal-per-Integritet-2024-2027.pdf<br><br>2. Po, komuna jonë ka caktuar me vendim zyrtarin Valmir Gashi, Koordinator i cili monitoron dhe raporton për Planin Komunal për Integritet.<br>Të bashkangjitur gjeni vendimin.<br>PDF<br>NRP-2587-02-2022-<br>Vendim për caktimir | |
| 4.4.Të përmirësohet implementimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve | Zyra ligjore/Zyra informimit | 1 Çfarë veprime ka ndërmarrë Komuna për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal, duke përfshirë gjuhët në përdorim zyrtarë, sipas UA. Nr. 01/2022.<br><br>2.A publikohen të gjitha aktet komunale në gjuhët zyrtare ashtu sic parashihen me ligjin për përdorimin e gjuheve si dhe rregullores komunale për gjuhët zyrtare? | 1. Komuna e Rahovecit ka miratuar rregulloren për përdorim të gjuhëve zyrtare.<br>Ka punësuar përkthyesin i cili bënë përkthimin e dokumenteve zyrtare të cilat shqyrtohen dhe miratohen pranë kuvendit të komunës.<br>Bënë publikimin e akteve të miratuara në web faqen zyrtare.<br>Përkthyesi bënë përkthimin dhe publikimin e lajmeve dhe informatave të nevojshme.<br><br>2. Po, të gjitha aktet të cilat shqyrtohen dhe miratohen pranë Kuvendit Komunal. | |
| 5. MBROJTJA DHE PROMOVIMI TRASHËGIMISË KULTURORE | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5.1.Avancimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore | **Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)** | 2. A është themeluar Muzeu i Natyrës në Komunën tuaj? **(Fushë Kosova)** | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5.2.Të implementohet legjislacioni që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore | **Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)** | 1. A ka hartuar komuna juaj Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore konfrom Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore ?<br><br>2. Nëse jo cilat janë sfidat/arsyjet që komuna juaj ende nuk e ka hartuar Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore ?<br><br>3. Sa është numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura?<br><br>4. Çfarë masa janë ndërmarrë ndaj shkeljeve të evidentuara të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura?<br><br>5.A janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive te objekteve të trashëgimisë kulturore (objektet e kultit fetar, zonat e mbrojtura, muzetë, etj) ?<br><br>6. A janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse? **(Vetem komunat qe kanë kisha) ?** | 1. Komuna jonë ka të hartuar Planin për Trashëgimin Kulturore konform Strategjisë Kombëtare për Trashëgimin Kulturore, e miratuar në Kuvendin Komunal Rahovec dhe konfirmim të ligjshmëris me datë 15.08.2022.<br>Shih linkun:<br>https://kk.rks-gov.net/Rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/08/DRAFT-Plani-i-trashegimise-kulturore-2022-2024.pdf<br><br>3. Në Komunën tonë nuk kemi ndërtime ilegale aty ku zonat janë të mbrojtura.<br><br>5. Po, kemi të instaluara kamera aty ku janë objektet të trashëgimis kulturore, muzet dhe objekte të kultit fetar. | |
| 5.3.Zbatimi i Ligjit për Hoçën e Madhe. Krijimi i Këshillit të fshatit dhe zgjedhja e anëtarëve për zbatimin e Ligjit për Hoçën e Madhe? Arsyet nëse nuk është bërë ende dhe cilat janë planet tuaja dhe të komunës | **Sekretaria e Kuvendit Komunal/Zyra për Fshatin Hoqë e Madhe** | 1. Cilat janë veprimet që komuna e Rahovecit ka ndërmarrë për funksionimin e Këshillit për Hocën e Madhe?<br><br>2. A është alokuar buxheti për Këshillin e fshatit të Hoqës së Madhe për të mundësuar funksionimin e | 1. Kuvendi komunës sipas ligjeve dhe udhëzimeve që janë në fuqi ka themeluar këshillin e fashatit Hoçë e Madhe me datë 31.05.2022.<br><br>2. Po me aprovim të buxhetit për vitin 2024 është ndarë rreth 29.00.00 € | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | suksesshëm dhe sa është shuma? | | |
| 5.5.Ndërmarrja e veprimeve në adresimin e problemit të ndërtimeve ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura (ZVM)? Raportim mbi aktivitetet e ndërmarra nga Task Forca e ngritur për t'u marrë posaçërisht me ndërtimet e paligjshme në Prizren. Planet e ardhshme për këtë Task Force sipas qeverisë së re | **Sekretaria e Kuvendit Komunal** | 1. Cilat janë veprimet e komunës për zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit?<br><br>2.A është alokuar buxheti për këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit për të mundësuar funksionimin e suksesshëm dhe sa është shuma?<br><br>3.Sa është numri i ndërtimeve ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit?<br><br>4.Çfarë aktivitete ka ndërmarrë Task Forca për sa i përket ndërtimeve të paligjshme, në Komunën e Prizrenit?<br><br>5. A janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit?<br><br>6. Cfarë aktivitete ka ndërrmarrë komuna e Prizrenit me qëllim të rehabilitimit të shtratit të lumit Lumbardhi? | | |
| 5.6. Raportoni lidhur me organizimin e fushatave të | **Drejtoria e Kulturës** | 1.Listoni aktivitetet që komunat ka ndërmarrë për | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizon aktivitet me të rinjët dhe nxënësit e shkollave të | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ndërgjegjësimit dhe promovimin e përkushtimit më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore | | ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ? | Komunës sonë, aty bëhet prezantimi dhe jepen informata për Trashëgimin Kulturore, theks të veçant ka kujdesi dhe ruajtja e monumenteve kulturore e historike në Komunën tonë. | |
| 2. BLLOKU II: KRITERET EKONOMIIKE | | | | |
| 1. EKZISTENCA E EKONOMISË FUNKSIONALE TË TREGUT | | | | |
| 1.1. Përmirësimi i mëtejmë i ambientit në të bërit biznes si dhe procedurat e planifikimit të buxhetit | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 1.A është themeluar Qendra për regjistrimin e bizneseve (*one-stop shopet*) në komunën tuaj?<br><br>2. Sa është numri i inspektorëve të tregut në komunën tuaj?<br><br>3. Sa është numri i inspektimeve gjatë periudhës raportuese?<br><br>4. Sa dëgjime publike janë mbajtur për planifikimin e buxhetit?<br><br>5.Sa është numri i bizneseve të regjistruara, ju lutem ofroni të dhëna vetëm për periudhën raportuese Janar-Qershor 2024 ?<br><br>6. Sa është numri i bizneseve të mbyllura, ju lutem ofroni të dhëna vetëm për periudhën raportuese Janar-Qershor 2019 ?<br><br>7.Sa është numri i bizneseve të udhëhequr nga gratë?<br><br>8.Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për subvencionimin e | 1. Po në komunën e Rahovecit, është e krijuar qendra për regjistrimin e bizneseve (One Stop Shop), ku të gjitha shërbimet për biznese merren në një vend.<br>Zyra është funksionale dhe procesi i punës zhvillohet normalisht.<br><br>2. Numri i inspektorëve të tregut në komunën e Rahovecit, është: 3<br><br>3. Gajtë periudhës raportuese numri i inspektimeve është: 280<br><br>4. Për planifikimin e Buxhetit janë mbajtur 5 dëgjime publike.<br><br>5. Për periudhën raportuese Janar-Qershor janë regjistruar 89 biznese të reja.<br><br>6. Për periudhën Janar-Qershor 2024 në komunën e Rahovecit janë mbyllur 10 biznese.<br><br>7. Numri i bizneseve që udhëhiqen nga gratë në Komunën e Rahovecit janë: 309 biznese.<br><br>8. Për vitin 2024 nga komuna e Rahovecit janë ndarë 20,000.00 € buxhet, për subvencionimin e bizneseve. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | bizneseve? | | |
| 2. TATIMET | | | | Neni 105 Tatimet – MSA |
| 2.1.Zvogëlimi i nivelit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal; | **Drejtoria e Inspektoriatit** | 1. Cilat janë masat që ka ndërmarrë komuna juaj ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale ? | 1. Janë obliguar që të pajisen me certifikata të biznesit, pranë qendrës për regjistrim të bizneseve si dhe janë marrë masa ndëshkuese. | |
| 2.2. Zbatimi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike | | 1. Sa rekomandime ka dhënë Zyra Kombëtarë e Auditimit (ZKA) në raportin më të fundit për Komunën tuj.<br><br>2. Sa rekomandime të ZKA-së i keni adresuar?<br><br>3. Sa rekomandime të ZKA-së kanë mbetur pa u adresuar?<br><br>4. Sa rekomandime të ZKA-së gjenden në proces?<br><br>5. A funksionon Njësia e Auditimit të Brendshëm në komunën tuaj, nëse po sa zyrtarë janë të angazhuar në këtë njësi?<br><br>6. A ka themeluar komuna juaj komitetin për auditim të brendshëm? | 1. Në raportin e fundit të Zyres Kombëtare të Auditimit për Komunën e Rahovecit, janë 9 Rekomandime, ku prej tyre 4 janë rekomandime të reja, 4 të përseritura dhe 1 rekomandim i ri.<br><br>2. Gjithësej janë adresuar 9 Rekomandime.<br><br>3. Asnjë Rekomandim nuk ka ngeluar pa u adresuar në raportin e fundit të ZKA.<br><br>4. Gjithësej 9 Rekomandime gjenden në proces.<br><br>5. Po.<br><br>6. Po. | |
| 2.3. Planfikimi i pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal | | 1. A është publikuar regjistri i pronës komunale, bashkangjitni linkun i regjistrit të pronave në kuadër të ueb faqeve zyrtare të komunave ? | 1. Po, kjo listë publikohet çdo vit.<br>Të bashkangjitur e gjeni linkun.<br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/?page=2023 | |
| 3. NDËRMARRJET DHE POLITIKAT E INDUSTRISË<br>13 | | | | |
| 3.1.Ndërtimi i një infrastrukture fizike, të kompletuar dhe të gatshme për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve | | 1. A është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike në komunën tuaj? | 1. Me datë 27.03.2023 ka filluar ndërtimi i zonës ekonomike në Komunën e Rahovecit dhe është në fazën e ndërtimit.<br>Ky projekt bashkëfinancohet me MINT dhe është projekt 3 vjeçar. | |
| 3. BLLOKU III: STANDARDET EVROPIANE | | | | |

| 1. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL | | | | Neni 26 i MSA-së: Bujqësia dhe Peshkataria |
|---|---|---|---|---|
| 1.1. Rregullimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe mbrojtjes nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore | **Drejtoria për Bujqësi** | 1. A ka hartuar komuna juaj Plan Program për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?<br><br>2. Sa është numri i kërkesave të parashtruara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore?<br><br>3. Sa është numri i vendimeve të miratuara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore?<br><br>4.A keni raste në komunën tuaj të humbjes së tokës Bujqësore?. | 1. Po, në çdo fillim të vitit hartohet plan programi i DBPZHR-së. Edhe këtë vit e kemi hartuar planin dhe e kemi publikuar në webfaqen e Komunës.<br>Bashkëngjitur e keni linkun:<br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/12/20231226134704291.pdf<br><br>2. Gjatë kësaj periudhe ishte vetëm një kërkesë për ndrrim destinimin e tokës bujqësore.<br><br>3. Një kërkesë ka qenë e cila poashtu është miratuar.<br><br>4. Po kemi raste të humbjes së tokës bujqësore, edhe pse ne mundohemi mjaftë shumë që ta ruajmë. | |
| 1.2.Konsolidimi i mëtejmë i qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural | **Drejtoria për Bujqësi** | 1. A janë funksionalizuar qendrat informative për këshillimin e fermereve në komunën tuaj?<br><br>2.A ka mbështetur komuna juaj fermerët në sektorin e drithrave, hortikulturës, blegtorisë etj nëse po ju lutem cekni sektorin dhe numrin e fermerëve të përkrahur? | 1. Po, janë funksionale në kuadë të MBPZHR-së, Shërbimet Kshillimore, Rural të Kosovës. Në kuadër të DBPZHR-së është lidhur kontratë për ofrimin e shërbime konsulente rreth përgatitjes së dokumenteve për aplikim në skemën e granteve në Ministri të linjës.<br><br>2. Po komuna jonë i ka mbështetur gjithmonë fermerët si me grante ashtu edhe me subvencione. Kete vit ka përkrahur 495 fermer me preparate per luftimn e semundesj Cikadia e hardhis se Rrushit si dhe 1128 fermer me pleh Artificial.<br>Shih listat:<br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/05/Raport-i-Vleresimit.pdf<br><br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/06/20240613144908642.pdf<br><br>Në sektorin e blegtorisë kemi bërë vaksinimin e bagëtive, të trasha dhe bagëtive të imëta | |
| 1.3. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokës bujqësore | **Drejtoria për Bujqësi** | 1.Çfarë veprime ka ndërmarr komuna juaj për parandalimin e humbjes së tokës bujqësore? | 1. Komuna jonë ka inspektorë të bujqësisë. | |
| 1.4. Planet për menaxhimin e tokave rurale (zonimi) | **Drejtoria e Bujqësisë** | 1. A posedon komuna e juaj Planin për Menaxhimin e tokave rurale, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni | 1. Komuna jonë ka të miratuar Planin Zhvillimor Komunal i cili e definon sakt tokën Bujqësore.<br><br>Jo nuk posedon komuna, por jemi në bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | planin e miratuar ? | | |
| ENERGJIA | | | | Neni 114 Energjia- MSA |
| 2.1. Reformimi i strukturave institucionale në fushën e energjisë dhe ngritja e kapaciteteve të tyre, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1. A ka miratuar komuna juaj Planin për Efiqiencë të Energjisë, konform Ligjit për Energji Elektrike nëse po, ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ?<br><br>2. Cilat janë projektet konkrete për zbatimin e planit për eficencë të energjisë, specifikoni së paku tri projekte? | 1. Komuna e Rahovecit e ka të miratuar planin për energji dhe klimë, shih Planin në vegëz: https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/11/Plani-Komunal-i-Veprimit-per-Energjine-dhe-Klimen-PKVEK.pdf<br><br>2. Komuna e Rahovecit përmes projekteve konkrete ka realizuar një sërë investimesh si në: Shkolla fillore "Rilindja", Çiflak, "Isa Boletini", Rahovec, "Bekim Sylka", Rahovec dhe shërbimet esco për digjitalizimin e rrjetit të ndriçimit publik. | |
| 4. GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE | | | | |
| 4.1.Zbatimi i pakove ligjore për të drejtat e njeriut | **Njësia për të Drejtat e Njeriut** | 1. A është emëruar zyrtari përkatës për mbrojtjen nga diskriminimit ?<br><br>2.A është emëruar zyrtari përkatës për Barazi Gjinore?<br><br>3. Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut ? | 1.Me vendimin Nr.1568 të datës 07.12.2020, Habibe Haxhimustafa, është emruar zyrtare Kundër Diskriminimit.<br><br>2. Komuna ka emëruar Alban Gashi, zyrtar për Barazi Gjinore, Akt Emërimi Nr. 1812 me datë 30.03.2022.<br><br>3. Komuna e Rahovecit i ndanë buxhet Zyres për Barazi Gjinore në shumë prej 2000.00 € për mallra dhe shërbime. | |
| 4.2 Zbatimi i pakove ligjore për Kujdesin për të moshuarit | | 1.A ofron Komuna juaj përkujdesje rezidenciale për të moshuarit, konform legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë?<br><br>2.Nëse po, sa qendra të përkujdesjes për të moshuarit gjenden në Komunën tuaj? | 1.Momentalisht Komuna e Rahovecit nuk ka përkujdesje rezidenciale për të moshuarit por Komuna ka arritë të ndërtoj një shtëpi për pleq për qëndrim ditor, objekti ka përfunduar. Pritet që së shpejti ky objekt të jetë në funksion.<br><br>2. Komuna e Rahovecit ka një qendër për qëndrim ditor, e cila pritet të jetë në funksion. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4.2.Të drejtat e grave dhe barazia gjinore | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete** | 2. A ka hartuar komuna juaj Planin e Veprimit kundër dhunës në familje, konfrom strategjisë kombëtare nëse po ju lutem të bashkangjiteni dokumentet e miratuar ?<br><br>3. Sa raste të dhunës mbi baza gjinore ka trajtuar komuna juaj dhe sa janë trajtuar ?<br><br>4.Cfarë masa ka ndërrmar komuna juaj për viktimat e dhunës në familje konform ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje ?<br><br>5.A ka themeluar komuna këshillin komunal (komitet) për mbrojtën e viktimave te dhunës në familje, nëse po sa takime janë mbajtur? | 2. Komuna e Rahovecit me datë 24.05.2024 ka themeluar Mekanizmin Komunal koordinues kundër dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, dhe në takimin e parë të këtij mekanizmi në muajin Korrik do të diskutohet për Planin e Veprimit kundër dhunës në familje, konfrom strategjisë kombëtare që është në proces e sipër.<br><br>3. Raste të dhunës në familje të raportuar në stacionin Policor në Rahovec për periudhën Janar deri 24.06.2024 janë gjithsej 30 raste të raportuara.<br><br>4. Në rastet e dhunës në familje Policia e Kosovës stacioni policor në Rahovec ka ndërmarr çdo veprim konform ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje për sigurinë e viktimës fëmijëve të saj në rastet kur ka pas dhe dëshmitarëve te rastit, arrestimin e kryesve të dhunës etj. Në 5 nga rastet e raportuara viktimat janë strehuar ne Strehimore në Gjakovë ndërsa në ndonjë rast viktimat janë dërguar në vendet ku ato janë ndier të sigurta qoftë familje të tyre apo adresa tjera ku ato kanë kërkuar dhe janë ndier të sigurta.<br>Çdo ankesë e raportuar është punuar në bashkëveprim me Prokurorin kujdestar pranë prokurorisë Themelore në Gjakovë e po ashtu për çdo rast të raportuar janë njoftuar Qendra për pune Sociale edhe Mbrojtësi i Viktimave te rastet e dhunës në familje.<br><br>5. Komuna ende nuk ka themeluar këshillin komunal (komitet) për mbrojtën e viktimave të dhunës në familje, Në maj të vitit 2024 nga Kryetari i Komunes është formuar Mekanizmi Komunal koordinues kundër dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. | |
| 4.3.Të fuqizohet roli dhe pozita e grave në shoqëri | **Njësia për të Drejtat e Njeriut** | 1. Sa është numri i grave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë (p.sh. administratë, shkolla, QMF etj) ?<br><br>2.Sa është numri total i përfaqësimit të grave në administratën publike lokale duke përfshirë Kuvendin e Komunës, dhe komunitetin jo shumicë ?<br><br>3. Sa ështe numri i grave që janë Drejtore të Drejtorive në Komunën tuaj? | 1. Numri i grave në pozita menaxheriale është:<br>• 3 Drejtoresha të drejtoris<br>• 5 Drejtoresha të shkollave<br>• Në Arsim 385 femra dhe 466 meshkuj<br>• QMF- Gjithsej 154 prej tyre 80 femra 74 meshkuj<br><br>2. Administrata komunale ka 37 Femra dhe 110 Meshkuj, prejt tyre 8 janë nga komuniteti jo shumicë.<br>Kuvendi komunal ka 31 anëtar, prej tyre 11 femra dhe 20 meshkuj.<br><br>3. Në komunën e Rahovecit, 3 drejtori udhëhiqen nga gratë. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4.4.Zbatimi i të drejtave pronësore | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/Zyra për Barazi Gjinore** | 1. Cilat janë veprimet që ka ndërrmarr komuna juaj me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, dhe cila është natyra e tyre?<br><br>2. Sa prona janë të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve? | 1. Ka mbajtur tryeza me gratë me temën "Të drejtat në Pronë", ka respektuar Udhëzimin Administrativ për Regjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortëve, shërbim që është ofruar pa pagesë.<br><br>2. Numri i regjistrimit të pronës në emër të të dy bashkëshortëve Janar - Qershor është 6. | |
| 4.5. Zbatimi i Ligji për Mbrojtjen e fëmijës | | 1. Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqësohet komuna juaj në zbatimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës?<br><br>2.A është themeluar ekipi për të drejtat e fëmijës sipas UA.06/22 .<br><br>3. A është organizuar ndonjë fushatë vetëdijësuses-edukese në komunën tuaj mbi promovimin dhe njohjen e të drejtave te fëmijëve në kuadët të EDF.<br><br>4. A është caktuar zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës ?<br><br>5. A janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, hapësirat e punës në institucionet publike?<br><br>6.A janë të qasshme objektet arsimore për personat me aftësi të kufizuar?<br><br>7.A kane asistencën e duhur në procesin mësimor fëmijët me aftësi të kufizuar, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë?<br><br>8. A ofron Komuna Juaj kujdestari për fëmijës pa përkujdesje prindërore sipas formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, bazuar në legjislacionin në fuqi. | 1./<br><br>2. Kryetari i komunës ka formuar Ekipin për të drejtat e fëmijëve me 30.03.2023.<br><br>3. Po.<br><br>4. Po është caktuar zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës<br><br>5. Janë pjesërisht të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, komuna pritet që së shpejti të ndërtoj një ashensor.<br><br>6. Po janë të qasshme.<br><br>7. Sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë personat me aftësi të kufizuara kanë asistencë të duhur në procesin arsimor.<br><br>8. Bazuar në legjislacionin në fuqi Komuna jonë ofron kujdestari për fëmijët pa përkujdesje prindërore sipas formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| 4.6.Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore | **Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete /Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** | 1. A është e hapur fushata vjetore në parandalimin e trafikimit me njerëz në Komunën tuaj? Nëse po ju lutem renditni aktivitetetet?<br><br>2.A e ka të miratuar Komuna Juaj Planin tre-vjeqar për strehim Social konform Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit ? Nëse po ju lutem ta bashkëngjitni Planin? | 1..Stop Trafikimeve me qenje njerzore<br>2.Traumat e viktimës se trafikimit<br>3. Trafikimi i te miturve<br><br>2. Kuvendi Komunal ka miratuar Planin tre-vjeçar për Banim Social.<br>Vegëza:<br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/11/PROGRAMI-KOMUNAL-TRE-VJECAR-PER-BANIM-2022-2025.pdf | |
| 4.7.Incimi i funksionalizmit të Komunitetit Konsultativ për Personat em Aftësi të Kufizuar | | 1. A është themeluar Komiteti konsultative për Personat me aftësi të kufizuara në komunën tuaj? Nëse po sa takime ka mbajtur? | 1. Po është themeluar Komiteti konsultative për Personat me aftësi të kufizuara, në gjashtë mujorin e parë ky komitet ka mbajtur tre takime. | |
| 4.8. Ofrimi i ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim etnie<br><br>**7 (shtatë) regjione të Republikës së Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë dhe Gjilan.** | **Drejtoria e Administratës** | 1.A është funksionalizuar Zyra Rajonale për ndihmë juridike falas ? (**Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë**).<br><br>2. A janë themeluar në komunë tuaj Zyrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike konfrom Ligji nr. 04/l-017 për ndihmë juridike falas<br><br>3. Sa është numri i kërkesave për ndihmë juridike falas në komunën tuaj? | 2. Komuna e Rahovecit me datë 12.01.2023 ka nënshkruar "Memorandum për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim" me Drejtorin Ekzekutiv të Organizatës Joqeveritare Banimi Social dhe të Drejtat Pronësore të Kosovës me qëllim të ofrimit të shërbimve dhe Ndihmave Juridke Falas në komunën e Rahovecit.<br>Ky projekt mbështetet nga USAID - Justice Activity dhe Implementohet nga OJQ SHPRK.<br><br>3. Kërkesa dhe Këshilla Ligjore në muaj sillen rreth 7/8 raste, ku përfshihen më se shumti Kërkes për ndihma Momentale apo mirëqenie sociale për Komunen e Rahovecit.<br>- Ankesa<br>- Kshilla Ligjore<br>- Kshilla te ndryshme | |
| 5 .MBROJTJA E MINORITETEVE | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5.1.Buxheti dhe sfidat në nivel qendror dhe lokal | | 1.Sa është numri i të punësuarave në të gjitha institucionet e komunës, nga komunitet jo shumicë në pajtim me përqindjen e popullatës në komunë ? | 1.Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ka informacion për të punësuarit në shërbimin civil, ku aktualisht janë 5 gra nga komuniteti serb, 3 meshkuj nga komuniteti serb dhe 1 mashkull egjiptian.<br>Në arsim janë 15, në shëndetësi janë 4.<br>Gjithsej janë 27 nga komuniteti jo shumicë. | |
| 5.2. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet Rom dhe Ashkali, përmirësimi i shkallës së regjistrimit civil për komunitetet rom, dhe ashkali | **Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim** | 1. A është realizuar fushata për regjistrimin falas të Komuniteteve Rom Ashkali dhe Egjiptian?<br><br>2. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni këtë Plan? (për komunat që i kanë këto komunitetet)<br><br>3. A është themeluar komiteti lokal veprues për zbatimin e Strategjisë për komunitetin Rom dhe Ashkali. | 1. Fushata për regjistrimin falas të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian është vazhdimisht e realizuar nga ZKKK. Aktualisht, së bashku me organizatën CRPK, jemi duke asistuar në regjistrimin e një familjeje, e cila nuk është fare e regjistruar në librat amzë dhe jemi duke proceduar për veprime të mëtejshme.<br><br>2. Po, Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian është miratuar më 30 gusht 2023 dhe po punohet me një intensitet të lartë sipas objektivave të tij dhe është i publikuar në faqën zyrtare të komunës. Vegza:<br><br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/09/Vendim-per-miratimin-e-Plani-i-veprimit-per-perfshirjen-e-komunitetit-Rom-dhe-Ashkali-2023-2025.pdf<br><br>3. Po, komiteti lokal veprues për zbatimin e Strategjisë për komunitetin Rom dhe Ashkali është themeluar dhe deri tani ka mbajtur 3 takime zyrtare me anëtarët mbi ecurinë e zbatueshmërisë së planit. | |
| 6. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA | | | | Neni 83 Liria, Siguria dhe Drejtësia- MSA |
| 6.1.Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafruar | **Zyra Komunal për Kthim dhe Komunitete** | 1.A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?<br><br>2.A ka themeluar komuna juaj Komisionin Komunal për Riintegrim (KKR)? | 1. Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim në Rahovec është miratuar në vitin 2023 dhe implementohet sipas planit dhe objektivave të parashikuara me rregulloret për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Vegza:<br><br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/05/vendim-per-miratimin-e-Planit-per-ri-integrimin-e-qendrueshem-te-personave-te-riatdhesuar-dhe-integrimin-e-te-huajve-ne-Rahovec-2023-2025.pdf<br><br>2. Po, komuna jonë ka themeluar Komisionin Komunal për Riintegrim (KKR). Ky komision trajton të gjitha rastet e riatdhesimit me përbërje të drejtorive dhe akterëve të tjerë sipas ligjit dhe rregulloreve në fuqi. | |
| 7.MENAXHIMI I KUFIJVE DHE MIGRIMIT | | | | Neni 85- Vizat,menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni- MSA |
| 7.1. Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur | | 1. Sa është numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunën tuaj? | 1. Gjatë vitit 2023 dhe gjatë 6 mujorit të vitit 2024, nuk kemi pasur asnjë kërkesë për kthim të qëndrueshëm nga vendet e rajonit, pasi nuk është funksional programi RRK6 i mbështetjes së kthimit të qëndrueshëm nga Ministria për | Sa i përket të riatdhesuarve nga diaspora (vendet e treta) nga Evropa, kemi trajtuar 5 raste të riatdhesimit. Atyre u është dhënë asistenca sipas rregulloreve në fuqi, dhe janë vazhduar angazhimet e tyre në trajnime profesionale në fusha të ndryshme, sipas interesimit që kanë treguar. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim/ Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale** | 2. Sa është numri i shtëpive të (ri)ndërtuara për të rikthyerit?<br><br>3. Sa është numri i aplikimeve për asistencë nga fondi për ri-integrim?<br><br>4. Sa është numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar? | Komunitete dhe Kthim. | |
| 7.2. .Puna dhe roli i Këshillat Lokale për Siguri Publike, (KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, (EVSB) të cilat përveç që duhet të jenë funksionale ato duhet të jenë edhe produktive | **Zyra e Kryetarit të Komunës** | 1. A është themeluar KKSB në Komunën Tuaj?<br><br>2. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga KKSB ?<br><br>3. A është themeluar Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP) në komunën tuaj ?<br><br>4. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga (KLSP) ?<br><br>5. A është themeluar EVS në Komunën tuaj?<br><br>6. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga EVS ?<br><br>7. A janë themeluar Këshillat e Fshatrave në komunen tuaj konform Udhezimi Administrativ 02/2019 MAPL per bashkpunimin e komunes me fshatra, nese po te bashkangjiten vendimet perkatese?<br><br>8. Sa takime kanë mbajtur në këtë periudhë? | 1. Po është themeluar me vendim të kuvendit me datë 28.01.2021.<br><br>2. Janar-Qershor janë mbajtur 4 takime të KKSB-së.<br><br>3. Po është i themeluar në komunën tonë, dy , Sektori A – Rahovec dhe Sektori C- Ratkoc.<br><br>4. /.<br><br>5. EVSB është themeluar në Komunën tonë.<br><br>6. /<br><br>7. Komuna e Rahovecit i ka gjithsej 33 fshatra dhe 5 lagje urbane. Gjithsej janë 38 këshilla lokal. Nuk janë themeluar 6 fshatra dhe 2 lagje urbane.<br>Vegza:<br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/06/Raporti-i-Komisionit-per-zgjdhjen-e-Kryetareve-te-fshatit-dhe-lagjeve-urbane.pdf | |

| 8. ARSIMI DHE KULTURA | | | | Neni 107 Arsimi dhe trajnimi - MSA |
|---|---|---|---|---|
| 8.1.Ngritja e kapaciteteve teknike për Arsimin Gjithpërfshirës | Drejtoria e Arsimit | 1. Sa trajnime janë mbatjtur gjatë periudhës raportuese për mësimëdhënës ? | 1. Gjatë periudhës raportuese është mbajtur një trajnim me mësimdhënës për fushat kurrikulare dhe ky trajnimështyë organizuar për mësimdhënës nga 3 fushat kurrikulare, nga Gjuhët dhe Komunikimi, nga Shkencat e Natyrës dhe nga Shkencat Shoqërore. | |
| 8.2. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta | Drejtoria e Arsimit | 1. Sa është numri i çerdheve funksionale *(publike dhe jo-publike)* në komunën tuaj?<br><br>2. Sa është numri i fëmijëve prej moshës 0-5 vjec që janë të përfshirë në çerdhe?<br><br>3.Sa është numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët janë përfshirë në çerdhe? | 1. Në komunën tonë tashmë kemi 4 çerdhe publike funksionale, në Rahovec, në Xërxë, në Ratkoc dhe në Krushë të Madhe.<br><br>2. Numri i përgjithshëm aktual i fëmijëve prej moshës 0 – 5 vjeç të përfshirë nëpër çerdhe është 313 fëmijë.<br><br>3. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët janë përfshirë në çerdhe është 11 fëmijë. | |
| 8.3. Raportim me të dhëna mbi numrin e braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë, në veçanti komuniteti Rom Ashkali Egjiptian. Veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna në parandalimin e mëtejshëm të braktisjes së shkollimit | Drejtoria e Arsimit | 1.Komuna juaj a has në mungesë të librave shkollore në gjuhët e komuntiteteve pakicë?<br><br>2.Sa është numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga komuniteti jo shumicë?<br><br>3.A ka organizuar komuna juaj trajnime për ekipet e parandalimet të braktisjes së shkollës, nëse po ju lutem specifikoni numrin e trajnimeve?<br><br>4. A ka hartuar komuna juaj Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit e shkollimit për komunitet jo shumicë (rom dhe ashkali) konform strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, nëse po ju lutemi të bashkangjiteni këtë Plan?<br><br>5. A janë formuar ekpiet për parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla në | 1. Fëmijët e komuniteteve pakicë, romë ashkali dhe egjip[tianë janë plotësisht të integruar me nxënësit e komunitetit shumicë, me shqiptarë dhe ata shkruajnë e flasin shqip. Ata nuk kanë nevojë dhe nuk kanë shprehur interesim për tekste në gjuhët e komuniteteve.<br><br>2. Gjatë periudhës raportuese kemi pranuar raporte nga shkollat për braktisjen e shkollimit nga komunitetet jo shumicë dhe janë gjithsej 3 raste, të cilat kanë ndodhur në 3 shkolla fillore të ndryshme.<br><br>3. Jo. Nuk kemi pasur trajnime të tilla, sepse Drejtoria Komunale e Arsimit e ka të themeluar Ekipin për Parandalimin e brakltisjes dhe mos regjistrimit të nxënësve, ekip i cili vazhdimisht merret me këtë çështje.<br><br>4. Jo. Nuk kemi plan të tillë.<br><br>5. Po. Në kuadër të DKA-së funksionon Ekipi për | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | komunen tuaj? | Parandalimin e Braktisjes dhe Mosregjistrimit të nënësve. | |
| **9. MJEDISI** | | | | **Neni 115 Mjedisi- MSA** |
| 9.1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1. A është hartuar plani komunal për menaxhimin e mbeturinave konform ligjit nr. 04/1-060 për mbeturina.Nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?<br><br>2. Sa është numri i fushatave të ndërmarra për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave?<br><br>3.Cilat janë veprimet e ndërrmara nga komuna e Obiliqit për mbrojtjen e qytetarëve lidhur me mbylljen e liqenit të depozitës së hirit të qymyrit që operohet nga KEK-u dhe deponisë së Mirashit ? Obiliqi<br><br>4. A është hartuar plani i veprimit për cilësin e ajrit në komunën tuaj, konform Ligjit nr. 03/1-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ( *shihni nëse Planet lokale të veprimit për cilësinë e ajrit janë pjesë integrale e planeve lokale për mjedis*) ? | 1. . Po, është miratuar plani komunal për menaxhimin e mbeturinave.<br>Vegza<br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2022/11/PLANI-KOMUNAL-PER-MENAXHIM-TE-MBETURINAVE-2022-2027.pdf<br><br>2. Kemi pas fushta për edukim mjaft në shkollat fillore rreth 20 fushata për ndërgjegjësim.<br><br>4. Po, në komunën e Rahovecit është hartuar Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit<br>Vegza:<br>https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/02/Plani-Lokal-i-Veprimit-per-Cilesi-te-Ajrit-2024-2029.pdf | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 9.2 Numri i madh i deponive ilegale duhet të adresohet urgjentisht | **Drejtoria e Shërbimeve Publike** | 1. Sa është numri i deponive ilegale në komunën tuaj dhe çfarë masa ka ndërmarrë komuna për të eliminuar këto deponi? | 1. Janë 11 deponi të evidentuara.<br>Komuna ka një kontratë me një kompani për eleminimin e deponive. | |
| 10. MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE E SHËNDETIT PUBLIK | | | | **Neni 81 Mbrojtja e konsumatorit- MSA** |
| 10.1 Mbrojtja e Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues | **Drejotria e Administrates /Drejtoria e shëndetësis** | 1. A ka pasur fushata vetëdijësues në komunën tuaj lidhur me shëndetin riprodhues ?<br><br>2.Sa trajnime ka organizuar komuna juaj për shëndetin e nënës dhe e fëmijës?<br><br>3. A janë të qasshme objektet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar? | 1. Fushata në komunitet nuk kemi pasur por në QKMF në njësine e maternitetit përkatësisht në dispanzer ekziston Këshillimorja për shëndetin riprodhues që mirret direkt me këshillat rreth kësaj fushe.<br><br>2. Ka 2 vite rradhazi që stafi i QKMF-së është trajnuar nga UNICEF dhe AMC për këto trajnime dhe ofron shërbimin vizitat në shtëpi për nëna dhe femijë nga viti 2022.<br><br>3. Po të gjitha objektet shëndetësore janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuar. | |